



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 janar 2015
Nr. ref.: RK744/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI114/14

Parashtrues

Adem Hoti

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Adem Hoti, me vendbanim të përhershëm në Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin është hedhur poshtë, si i palejuar, revizioni i ushtruar nga parashtruesi kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 3661/2013, të 28 shkurtit 2013 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014. Më këtë aktvendim të Gjykatës Supreme, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3.2 dhe me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Bazë juridike për këtë rast është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe neni 22 e neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin NR. GJR. KI114/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin NR. KSH. KI114/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Prof. dr. Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.
7. Më 22 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 30 janar 2013, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë është lidhur Ujdia gjyqësore C. nr. 433/11, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Podujevë (në tekstin e mëtejme: DKA në Podujevë) për sistemimin e parashtruesit në sistemin e pagave për vitin shkollor 2013/2014. Në ujdinë e lidhur gjyqësore ceket që, DKA në Podujevë, obligohet t'ia paguajë parashtruesit pagat për muajt: korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor dhe janar, nga 215.90 €, gjithsej 1295.40 €. Pagat e papaguara, sipas Ujdisë, DKA në Podujevë do të duhej t'ia paguante parashtruesit në muajin shkurt të vitit 2013, kurse kontrata mbi vepër do t'i

vazhdohej deri më 30 qershor të vitit 2013. Po ashtu, DKA në Podujevë është obliguar që t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë që, në fillim të vitit shkollor 2013-2014, ta sistemojë parashtruesin në sistemin e pagave.

10. Më 1 tetor 2013, parashtruesi ka ushtruar propozim për lejimin e përmbarimit të Ujdisë gjyqësore C. nr. 433/11 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, duke pretenduar se Ujdia gjyqësore C. nr. 433/11, e lidhur ndërmjet tij dhe DKA-së në Podujevë, nuk është zbatuar plotësisht nga ana e DKA-së në Podujevë.
11. Më 8 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë (Aktvendimi CP. nr. 439/13) refuzoi propozimin për lejimin e përmbarimit të ushtruar kundër DKA-së në Podujevë.
12. Për më tepër, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, konstatoi:

“[...] Nga kontrata për punën e lidhur me kohë të caktuar (mbi veprën), paditësi-kreditori vërtetohet se ka pas kontratë prej 1.06.2013 deri më 31.08.2013, andaj meqenëse është një kontratë e llojit të tillë kjo ka mundur të mos i vazhdohet nga debitori pas kalimit të afatit 31.08.2013, dhe nuk është obliguar e paditura-debitori drejtoria për arsim kulturë dhe shkencë nga komuna e Podujevës që ta vazhdoi nëse nuk ka nevojë për punëtor dhe vendin e punës

Nisur nga kjo gjendje gjykata është e mendimit se kreditori nuk ka të drejtë dhe për këtë iu refuzua propozimi i tillë si i pabazuar. Nëse mendon se iu kanë shkelë të drejtat, mund ti realizoj të drejtat e tij në kontest të rregullt civil e jo në këtë procedurë përmbarimore sipas propozimit të bërë dhe në bazë të ujdisë që është arritur në mes të palëve”.

13. Më 12 nëntor 2013, parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër aktvendimit të gjykatës së instancës së parë. Ankesa e parashtruesit është bazuar në shkeljen e dispozitave procedurale, përkatësisht neni 182.1, pika (n), i Ligjit për Procedurën Kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, përkatësisht të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), nr. 03/L-008.
14. Më 12 maj 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë (Aktvendimi AC. nr. 3661/13) refuzoi, si të pabazë, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së instancës së parë. Gjykata në fjalë konstatoi se gjykata e instancës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë korrekte dhe të drejtë ka aplikuar ligjin material.
15. Më 19 mars 2014, parashtruesi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të ligjit material.
16. Më 12 maj 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 127/2014) hodhi poshtë, si të palejuar, revizionin e ushtruar nga parashtruesi, nga arsyet e mëposhtme: *“Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, e në mbështetje të nenit 68 par. 1 të ligjit për procedurën e përmbarimit, Gjykata Supreme e Kosovës,*

gjete se, revizioni i kreditorit në këtë çështje juridike në bazë të dispozitës së sipër cituar të ligjit, nuk është i lejuar ndaj aktvendimit të formës së prerë në procedurën përmbarimore”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi ndihet i diskriminuar për faktin se DKA-ja dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 3.2 të Kushtetutës, si dhe nenin 113.7 të Kushtetutës, për shkak se Gjykata Supreme e hodhi poshtë revizionin si të palejuar.
18. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se gjykatat e rregullta padrejtësisht ia refuzuan propozimin për përmbarim, me të cilin ka kërkuar që në pajtim me Ujdinë gjyqësore C. nr. 433/11, të 30 janarit 2013, të sistemohet në sistemin e pagave për vitin shkollor 2013/2014, nga fillimi i vitit shkollor.
19. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me këto kërkesa, citojmë:
“Sistemim në vend të punës arsimtar i arsimit teknik ose mësues klase, apo edhe bibliotekist në shkollë fillore ose të mesme, si dhe shtëpiak në shkollë fillore apo të mesme ose ndihmës shtëpiaku në shkollën e mesme ekonomike ‘Isa Boletini’ në Podujevë”.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.
22. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) d) i Rregullores së punës parasheh:

*(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
23. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se punëdhënësi, DKA-ja në Podujevë, dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 3.2 të Kushtetutës, për faktin se nxorën vendime jo të drejta, dhe me nenin 113.7 të Kushtetutës, për shkak të hedhjes poshtë të revizionit, si të palejuar, nga Gjykata Supreme.
25. Sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit 3.2, Gjykata i referohet po kësaj dispozite kushtetuese, që përcakton:
- Neni 3.2. “Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”.*
26. Përkitazi me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesi në asnjë mënyrë nuk argumenton, si dhe pse, gjykata e instancës së parë dhe gjykata e instancës së dytë, shkelën të drejtën e tij të garantuar me këtë dispozitë konkrete të Kushtetutës, përderisa atij i janë dhënë të gjitha mundësitë e paraqitjes së fakteve, ngritjes së argumenteve dhe kundërshtimit të argumenteve të palës kundërshtare.
27. Parashtruesi, gjithashtu, pretendon se edhe Gjykata Supreme shkeli të drejtën e tij të garantuar me nenin 113.7 të Kushtetutës, për faktin se nuk e aprovoi revizionin e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
28. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se pretendimi i ngritur nga parashtruesi për shkeljen e kësaj dispozite të Kushtetutës nuk ka të bëjë me mundësinë e parashtrimit të një ankese a kërkesë në gjykatat e rregullta ose të mohimit të këtyre mjeteve juridike nga të njëjtat, por mundësinë që individët, qytetarët e Republikës së Kosovës, t'i kontestojnë vendimet e gjykatave të rregullta në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, me kusht që ata të provojnë se i kanë shterur të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
29. Për më tepër, nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se, vendimi përfundimtar për çështjen e parashtruesit, sipas ligjit në fuqi, është Aktvendimi Ac. nr. 3661/13 i Gjykatës së Apelit, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i gjykatës së instancës së parë, CP. nr. 439/13, i 8 nëntorit 2013, përkitazi me propozimin e parashtruesit për përmbarrimin e Ujdisë gjyqësore C. nr. 433/11, të 30 janarit 2013.
30. Mirëpo, vërehet qartë se parashtruesi është ndarë i pakënaqur me rezultatin e vendimit të Gjykatës së Apelit, dhënë në procedurë përmbarrimore, dhe është përpjekur që pretendimet e tij t'i realizojë në Gjykatën Supreme, e cila hodhi

poshtë, si të palejuar, revizionin për shkaqe procedurale (shih arsyetimin e Gjykatës Supreme në paragrafin 16 të këtij dokumenti).

31. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të parashtruar një kërkesë të argumentueshme për shkeljen e dispozitave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, ose Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, e 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha*, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).
32. Gjykata edhe më tutje thekson se nuk është gjykatë e faktit dhe nuk gjykon si gjykatë e instancës së katërt. Gjykata, në parim, nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike apo, siç është rasti konkret, të vërtetojë nëse punësimi i parashtruesit ishte ndërprerë në bazë ligjore apo joligjore, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën Kushtetuese, thelbësore janë ato çështje, prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria) dhe jo çështjet që janë qartazi ligjore, ligjshmëria (shih, *mutatis mutandis*, i. a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
33. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
34. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit, në përputhje me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (1) d), me rregullin 36 (2) b) e d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani